



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
**MINISTRIA E INTEGRIMIT
EUROPIAN**

Konsultim mbi Planin Kombëtar për Integrimin European 2017-2020

2016-11-24 15:14:00

Ministria e Integrimit European, së bashku me ministritë e linjës dhe institucione të tjera publike, gjatë periudhës tetor - nëntor 2016, bashkëpunuan në mënyrë intensive për përditësimin e Planit Kombëtar për Integrimin European 2017 – 2020 (PKIE 2017 – 2020). Plani Kombëtar për Integrimin European 2017 – 2020, si instrumenti kryesor për planifikimin dhe monitorimin e përafritit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, së bashku me dokumentet e tjera strategjike, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Raportin e Komisionit European për Shqipërinë dhe Partneritetin European, shërben si dokument shumë i rëndësishëm në procesin e integrimit european të Shqipërisë.

Në kuadër të programit të transparencës bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe detyrimin për konsultim publik të dokumenteve strategjike bazuar në ligjin nr.146.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ministria e Integrimit European sapo ka nisur procesin e konsultimeve të masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin European 2017 – 2020 (PKIE) me grupet e interesit në tërësi.

Në menunë e mësipërme gjeni projekt-Planin Kombëtar për Integrimin European 2017 - 2020, me qëllim njoftimin dhe konsultimin e tij me ju. Mirëpresim komentet tuaja lidhur me projekt-PKIE-në 2017-2020, në formë elektronike në adresën sshcs.mie@integrimi.gov.al, deri në datën **10 dhjetor 2016**.

Po ashtu, Ministria e Integrimit European, në koordinim me institucionet përgjegjëse për kapitujt e PKIE-së do të organizojë takime konsultative sipas **kalendarit dhe axhendës** në menunë e mësipërme. Jeni të ftuar të merrni pjesë sipas fushave të ekspertizës që ju mbulon. Mirëpresim **konfirmimet** tuaja për **pjesëmarrjen në këto takime konsultative** deri në datën **24 nëntor 2016**. Çdo pyetje apo koment i juaji lidhur me takimin konsultativ dhe pjesën e projekt-PKIE 2017-2020 të planifikuar për t’u konsultuar drejtpërdrejtë me ju sipas datave të agjendës bashkëlidhur, mirëpritet të dërgohet paraprakisht. Komentet dhe pyetjet tuaja do të na shërbejnë si bazë diskutimesh për këto takime konsultative.